



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË

Nr. _____ prot.

Datë _____ / _____ / 2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Bashkimin e operatorëve ekonomike **Arena MK shpk** dhe **Instituti Dekliada-Alb shpk**

Adresa: Fier Qender-MALLAKASTER DUKAS Rruga Nacionale Ballsh-Fier, Ndertesa private
Nr.2, Zona kadastrale 1566, Nr.pasurie 93/14.

Procedura e prokurimit: KËRKESE PËR PROPOZIM

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-54934-03-25-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

1. Fondi limit: **5,236,130.61 lekë pa tvsh**
(pesë milion e dyqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë pikë gjashtëdhjetë e një) .
2. Burimi i Financimit: **GRANTI**
3. Objekti i kontratës: **"SUPERVIZION PUNIMESH PËR OBJEKTIN: "RIKONSTRUKSION I RRJETIT SHPËRNDARËS PËR FURNIZIMIN ME UJË TË QYTETIT KAVAJË DHE NDËRTIMI I DEPO UJI TË RE, FAZA E DYTË "**.

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët** ●; oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Arena Mk shpk me Nipt L67619801Q dhe Instituti Dekliada -Alb shpk me Nipt K71606006A
vlera **4,381,500** (katër milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë pa tvsh
2. BN Project shpk me Nipt L21305035S; vlera **4,616,575** (katër milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh
3. Instituti I Konsulencës në Ndërtim "IKN" shpk, me Nipt K71828007J dhe IMES-D shpk me Nipt K82430006C; vlera **4,533,446** (katër milion e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e katër qind e dyzet e gjashtë) lekë pa tvsh
4. Net-Group shpk me Nipt L72023002P; vlera **4,616,575.13** (katër milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëdhjetë e pesë pikë trembedhjetë) lekë pa tvsh.
5. Nord-Comat shpk me Nipt L08501501Q; vlera **4,712,517.54** (katër milion e shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë pikë pesëdhjetë e katër) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Nord-Comat shpk
2. BN Project shpk
3. Net Group shpk

Përkatësisht për arsye të mëposhtme:

1. Operatori ekonomik **Nord-Comat** shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotëson këto kritere:

- Dokumentacioni i paraqitur për të provuar përvojën e mëparshme të operatorit ekonomik, nuk është në raport me kërkesat e pikës 2.3.1 të “Kapaciteteve Teknike” të DST, si dhe ka mangesitë si më poshtë:
- Faturat tatimore të lëshuara për blerësin Seed Consultin shpk nuk janë në gjuhën shqipe, siç përcaktohet në pikën 4.6 të kapitullit I-rë “Njoftimi i kontratës” të DST “Gjuha(-ët) për hartimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje është Shqip.”
- Faturat tatimore për dy objektet e tjera
 - Mbikqyrje dhe konsulence për projektin: “Vlora Water Front Promenade”
 - Mbikqyrje dhe konsulence për projektin: “Ndertim i rrugës Qukes-Qafe Plloqe, Tirane Korce, sek.1

te paraqitura për të vertetuar përvojën e mëparshme të operatorit ekonomik, për aq sa tregon përshkrimi i fatures, nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3.1 të “Kapaciteteve Teknike” të DST dhe të objektit të kontratës e cila ka natyrë punime të rehabilitimit të rrjetit shpërndarës të furnizimit me ujë.

- Kontrata për mbikqyrjen e punimeve të ndertimit me objekt “Rikonstruksion i ambienteve të brendshme të stadiumit” nuk plotëson kërkesat e pikës 2.3.1 të “Kapaciteteve Teknike” të DST dhe të objektit të kontratës e cila ka natyrë punime të rehabilitimit të rrjetit shpërndarës të furnizimit me ujë.
- Nuk është paraqitur asnjë dokument për të provuar se operatori ekonomik ka në dispozicion si staf mbështetës 1 (një) Inxhinier Hidroteknik, 1 (një) Inxhinier Ndertimi, 1 (një) Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder, siç përcaktohet në pikën 2.3.4.1 të “Kapaciteteve Teknike” të DST.

K.V.O. e cilëson ofertën e këtij operatori të refuzuar.

2. Operatori ekonomik **BN Project** shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotëson këto kritere:

- Nuk është paraqitur asnjë dokument për të provuar se operatori ekonomik i plotëson kërkesat e parashikuara në DST për kapacitetin ekonomik-financiar dhe kapacitetin Teknik.

K.V.O. e cilëson ofertën e këtij operatori të refuzuar.

3. Operatori ekonomik **Net Group** shpk u skualifikua duke qenë se nuk plotëson këto kritere:

- Operatori ekonomik nuk është i pajisur me licencë profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekti i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, të kategorisë NS 16, siç përcaktohet në pikën 2.3.2 të “Kapaciteteve Teknike” të DST.

* * * * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë BOE Arena MK shpk dhe Instituti Dekliada-Alb, se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **4,381,500** (katër milion e treqind e tetëdhjetë e një mijë e pesëqind) lekë pa tvsh është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Kavajë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të zbatohen dispozitat që parashikohen në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 13.04.2020

Ankesa: Nuk ka patur

Kryetari

Redjan KRALI